



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 168, datë 29.09.2021

PËR

**MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE “DEGA NË SHQIPËRI E SHOQËRISË
ERNST & YOUNG-EKSPERTË KONTABËL TË AUTORIZUAR”, PËR AUDITIMIN
E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGMA
INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A., PËR VITIN
FINANCIAR QË MBYLLET MË 31.12.2021**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të neneve 123 dhe 124, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e shoqërisë audituese “Dega në Shqipëri e shoqërisë ERNST & YOUNG-Ekspertë Kontabël të Autorizuar”, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit “Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2021.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE